

**Ma. Zylyftar BREGU**

## **SEKTORI I AGIT-PROPIT DHE INSTITUCIONALIZIMI I CENSURËS NË MEDIAN E SHKRUAR PAS VITIT 1944**

Çlirimi nga pushtuesit fashist ë gjeti Shqipërinë në një prapambetje të thellë ekonomike dhe kulturore. Historianët kanë mundur të provojnë se në këtë kohë vendi përjetonte ende një sistem ekonomik të bazuar në prodhimin agrar. Tregues domethënës i prapambetjes kulturore e arsimore ishte edhe gjendja e shtypit të shkruar.

Në prag të përfundimit të Luftës, kur pushteti i Partisë Komuniste po bëhej më i pranishëm, shtypi i saj e thelloi karakterin revolucionar. Ai filloi të atakojë me tone të forta të gjithë titujt e tjerë. Më pas organet e pushtetit revolucionar të krijuara sidomos pas Kongresit të Përmetit filluan të mbyllin njëra pas tjetrës të gjitha organet që binin në kundërshtim me frymën e Luftës dhe të këshillave Nacionalçlirimtare.

Kapitulli i shtypit të luftës u mbyll, në prag të çlirimit të Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë, me gazetën "Zani i Atdheut", organ i Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Kuislinge, botuar në Shkodër vetëm në dy numra, më 19 e 23 nëntor 1944.

Por pavarësisht kësaj, shtypi pas çlirimit trashëgoi nga lufta një numër gazetash si "Bashkimi", "Rinia", "Pioneri".

Megjithatë fituesit e luftës, Partia Komuniste shqiptare, duke ditur fuqinë e shtypit i kushtoi vëmendje të posaçme medias në dy aspekte; së pari rritjen dhe zhvillimin e shtypit dhe së dyti, kontrollin dhe kthimin e shtypit në një armë propagande.

Artikulli i mëposhtëm synon që të vëzhgojë mjetet, format dhe metodat që përdori shteti totalitar i kohës për të vendosur censurën në mediat e shkruar. Vërtetimi i këtij pretendimi do të realizohet duke parë dokumentet zyrtarë që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit si dhe duke analizuar median e kohës.

Teksa lexonte raportin e Qeverisë në shtator të vitit 1945, kreu i saj Enver Hoxha, jepte këto shifra për sa i përket shtypit në Shqipëri: "Në kryeqytet dhe krahina dalin 13 gazeta, nga të cilat njëra është e përditshme me një tirazh prej 12 000 copë. Gjerë më tani dalin 5 revista të përmuajshme nga të cilat njëra satirike e përdyjavshme. Janë vënë afro 40 libra të ndryshme në qarkullim, përveç atyre të botuara nga Ministria e Arsimit janë ngritur tre radio-stacione, një në Shkodër, një në Korçë dhe tjetra në

Gjirokastër, përveç Radio Tiranës është rindërtuar edhe Radio Lapraka<sup>1</sup>.

Megjithatë pavarësisht motiveve, cilësisë së profesionalizimit dhe përmbajtjes së tyre, duhet thënë se për më pak se katër vjet. media shqiptare kishte pësuar një hov të paparashikuar. Deri në gjysmën e parë të vitit 1948 ishte kjo situatë mediatike me tirazhet e tyre përkatëse; Gazeta "Bashkimi" organ i përditshëm i Frontit Demokratik të Shqipërisë më 1945 kishte një tirazh prej 12.000 copë, më 1946 14.000 copë, më 1947, 15 000 copë dhe sot 30 000. Gazeta "Hosteni", organ i përjavshëm satirik më 1945-46 kishte një tirazh prej 5 000 copë, më 1947, 6 000 copë dhe më 1948, 6 000 copë. Gazeta "Sporti" organ i përjavshëm i F.S.SH më 1945 kishte një tirazh prej 2900 copë, më 1946-1947, 3 000 copë dhe më 1948, 5 000 copë. Gazeta "Rinia" organ i Rinisë Popullore të Shqipërisë që del dy herë në javë më 1945 kish 4 000 copë, më 1946-1947 5 000 copë dhe më 1948, 7 mijë copë. Gazeta "Puna" organ i B.P.S që del dy herë në javë, në 1945 kishte një tirazh prej 4 100 copë, më 1946, 5 000 copë, më 1947, 8000 copë dhe më 1948, 10 000 copë. "Pioneri", organ i përjavshëm i organizatës së pionerit më 1945 kish një tirazh prej 3 000 copësh, më 1946, 6 000 copë, më 1947, 8 000 copë dhe më 1948, 13 000 copë. "Shqiptarja e re", organ i përmuajshëm i Bashkimit të Gruas Shqiptare, më 1945 kishte një tirazh prej 2 000 copë, më 1946, 2 5000, më 1947, 3 000 dhe më 1948, 8 000 copë. "Laiko Vima", organ i Frontit për Minoritetin Grek ka një tirazh prej 3 000 copë. "Arsimi" organ i Ministrisë së Arsimit doli më 1947 me 4 000 copë, pastaj u zëvendësua me "Arsimin Popullor" i cili tani ka një tirazh prej 5 mijë copë. "Letrari i ri", organ i rretheve letrare të rinjve që doli për të parën herë në muajin maj të këtij viti, ka një tirazh prej 5 000 copë. "Literatyra e jonë" ka një tirazh prej 2 500 copë. "Përpjekja fshatare" më 1946 ka pasur tirazh prej 4 400 copë, më 1947, 5700 copë dhe më 1948, 6 000 copë. "Për një paqe të qëndrueshme për një demokraci popullore" që del dy herë në muaj, del me një tirazh prej 8 000 kopjesh, "Udhëheqësi i pionerëve", i përjavshëm ka sot një tirazh prej 3 000 copë. "Luftëtari". organ i ushtrisë kombëtare që del dy herë në javë më 1946, ka pasur një tirazh prej 4 000-6 000 copë, më 1947, 12 000 copë, dhe më 1948 një tirazh prej 25 000 copë. Po kështu, revistat e ndryshme si "Shqipëri-B.R.S.S", që dalin të përmuajshme etj. kanë dalë me një tirazh prej 8 000 copë. Gjithashtu revista e Ushtrisë Kombëtare "10 korriku" i përmuajshëm ka një tirazh të madh, "Koperativa", revistë mujore ka një tirazh prej 4 000 copë. "Fatosi". organ i pionierëve të vegjël ka një tirazh prej 5 000 copë. "Radio Përhapja", revistë programatike e radio difuzionit të shtetit ka një tirazh prej 1697 copë<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> "Kryeministri paraqet raportin e Qeverisë". Bashkimi, Tiranë, 27 shtator 1945, Nr. 231, fq.3

<sup>2</sup> "Shtypi dhe botimet në vëndin tonë". Bashkimi, Tiranë, 23 shtator 1948, Nr. 1166, fq 5

Megjithatë, duhet thënë se në vitin 1948 madje qysh në vitin 1947, ishin mbyllur disa gazeta lokale, por edhe u shtuan disa revista ose buletine qendrore si dhe doli sërish në treg gazeta qendrore “Zëri i Popullit”.

### *Sektori i agjit-propit dhe unifikimi i propagandës*

Objektivi kryesor i programit politik të Partisë Komuniste ishte krijimi i një shtypi të ri që të përmbushte të gjitha interesat e saj në funksion të mbajtjes me çdo kusht të pushtetit politik. Për këtë qëllim ajo hartoi një strategji afatgjatë për indoktrinimin politik ideologjik të njeriut nëpërmjet shtypit dhe të ashtuquajturës fjalë e lirë.

Në publik, Partia Komuniste u prononcua se do të mbetej një besnike e parimeve demokratike të lirisë së fjalës, të mendimit të lirë. Por në fakt nëpërmjet krijimit të instrumenteve politikë dhe të institucioneve ajo mundi ta kontrollojë tërësisht median në funksion të interesave të veta.

Edhe pse, pranë, anash ose poshtë titujve të organeve mediatike shënohej “pronësia” e asaj gazete, pra nga varej, për shembull: Bashkimi i Rinisë, Bashkimi i Gruas, ky ishte një drejtim formal, simbolik. Praktikisht të gjitha organet e shtypit që dolën pas çlirimit duhet të “licensosheshin” nga organet e reja të pushtetit popullor. Partia Komuniste Shqiptare e dinte shumë mirë fuqinë e shtypit dhe menjëherë pas ardhjes në pushtet mendoi strategjinë për të “disiplinuar” pushtetin e katërt. Që në mesin e parë të vitit 1945, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste, pasi kishte formuar Komisionin e agjit-propit (Agjitacionit dhe Propagandës) në qendër u kërkon qarqeve që të ngrënë një strukturë të tillë edhe në bazë, pra në secilin qark. Madje në një telegram të nënshkruar nga Koçi Xoxe drejtuesit e Komiteteve të Divizioneve “fshikullohen” për ngadalësinë në ngritjen e kësaj strukture e cila në vend të profesionistëve të medias kërkonte komunistë të devotshëm.

“Qarkorja e jonë e fundit flet gjerë e gjatë për rëndësinë e agjit-propit dhe ngritjen e shpejtë të këtij aparati, duke përdorur shokë të mirë, të aftë dhe organizatorë, qoftë edhe se nuk kanë talent për të shkruar, mjafton të njohin mirë vijën e Partisë dhe të jenë organizatorë të mirë. Rreth kësaj pike s’është punuar. Urdhëroheni që ky aparat të ngrihet sa më parë që prej Divizionit e gjerë në batalion në bazë të udhëzimeve që u janë dhënë nga Komanda e Përgjithshme. Presim të na njoftoni përfundimin urgjent<sup>3</sup>.”

Kjo strukturë drejtuese e përmbajtjes së medias do të bëhet dalëngadalë edhe struktura censurose e shtypit, duke “mbytur” lirinë e fjalës, duke hartuar “këshillat e leximit” për mesazhet që jepeshin në media.

<sup>3</sup> AQSH. F 14. V. 1945. D. 140. fl 1 *Koçi Xoxe, radiogram më 2 VI.1945*

Pak muaj më vonë, në fillimin e vitit 1946 Komisioni i agjit-propit nis një tjetër material shpjegues për të argumentuar ngritjen e strukturës së agjit-propit dhe ka formuluar disa nga rekomandimet për suksesin e funksionimit të propagandës. Në këtë qarkore propozohet, vendoset që tash e tutje propaganda do të unisohet në të gjitha organet e medias që publikoheshin brenda kufijve të shtetit shqiptar dhe unifikimi ishte e drejtë vetëm e Partisë Komuniste.

Praktikisht me këtë qarkore “ekzekutohet” publikimi i mendimit ndryshe në media. Do të publikohej vetëm mendimi i unifikuar nga Komisioni i agjit-propit, që ishte struktura e varur nga Komiteti Qendror i PKS-së.

“Konditat e ndryshme kërkojnë që çështja e agjitacionit dhe e propagandës të shtrohet në mënyrë shumë të organizuar, që të udhëhiqet direkt nga qendra e Partisë, nga krahinorët, qarkorët dhe nga forumet e ulëta të Partisë. I gjithë agjitacioni dhe propaganda, puna kulturore dhe arsimore, organizohet dhe unisohet (e nënvizuar kjo. Shënim) nën udhëheqjen e Komiteteve të Partisë”<sup>4</sup>. Në këtë qarkore përcaktohen deri në detaje detyrat e propaganduesve të shpërndarë në të gjitha kapilarët e shoqërisë shqiptare.

“Krijohen aparate dhe bahet shpërndarja e drejtë e njerëzve sepse pa këto aparate nuk mund të kryhet puna. Aparatet do të zhvillohen paralel me punën: por të paktën në fillim krijohen aparatet bazë. prandaj:

E para: Pranë çdo komiteti krahinor, qarkor, etj., krijohen komisionet e agjitacionit dhe propagandës. Ndër celulat dhe byrotë caktohen shokët përgjegjës për këtë sektor.

E dyta: Në komisionet e Agjitacionit dhe Propagandës duhet bërë ndarja e drejtë e punës ndër sektorë: 1. Sektori për shtyp dhe agjitacion, 2. Sektori teorik-referues. 3. Sektori Kulturor. 4. Sektori organizues teknik. 5. Sektori pedagogjik. Në krye të çdo sektori caktohet përgjegjësi i sektorit. Gjithë komisionin e udhëheq një shok i forumit të partisë (byrosë), i cili drejtpërsëdrejti nuk udhëheq asnjë sektor. Atij i duhen të gjithë sektorët, secili veçanërisht në të gjithë përgjithësisht. Ky, kohë mbas kohe thërret në mbledhje ose këshillime përgjegjësit e sektorëve, zakonisht një herë në javë, në raste të veçanta sipas nevojave.

E treta: Detyrat e udhëheqësve të sektorit janë:

a) Përgjegjësi i shtypit dhe agjitacionit ka në kujdes gjithë shtypin e terrenit të tij si dhe shtypin qendror të Partisë. Kujdeset që në shtyp të shtrohet drejt çdo çështje politike ose tjetër çështje dhe të aplikohen e të kuptohen në shtypin e terrenit të tij direktivat e shtypit qendror. Ai interesohet se çfarë artikujsh dhe çfarë do të vihet në shtyp, çfarë do të

<sup>4</sup> AQSH. F.14. V. 1946. D. 131. ff 34-35

theksohet më tepër, çfarë do të vihet dhe çfarë të mos vihet në dukje. Ay kujdeset gjithashtu se çfarë formash agjitacioni (manifestime, demonstrata, konferenca, mbas darka, pllakate, vizatime, karikatura etj.) duhet të zhvillohen dhe të aplikohen në kondita të veçanta politike ose të ndryshme. Ai interesohet mbi njerëzit që do të futen në redaksinë e gazetës së Partisë ose të tjerave e ndër revistat. Ai merr gjithashtu pjesë (nëse e kërkon nevoja) ndër ndonjë nga redaksitë kryesore. Kjo mund të jetë vetëm një pjesë e punës së tij kurse ai duhet të ketë parasysh dhe të udhëheqë direkt ose indirekt gjithë shtypin dhe agjitacionin në rrethin e tij. Përgjegjësi i shtypit dhe agjitacionit udhëheqë gjithashtu edhe Aktivin e Agjitacionit.<sup>5</sup>

Idesë së centralizimit dhe “unisimit” të trajtimit të çështjeve të agjitacionit dhe propagandës i bashkëngjitet, duke e rënduar më shumë situatën edhe një tjetër telegram i majit të vitit 1946, i Komisionit të agjit-propit në Komitetin Qendror të PKS-së, drejtuar organeve të medias, sipas të cilit “vija që do të ndiqte shtypi do të përcaktohej çdo javë (nga Komisioni i agjit-propit, shënim). “Këndej e tutje mbas konferencave të shtypit që bëhen në qendër do t’u dërgohen edhe juve pikat kryesore ku do të përmbahet shtypi dhe propaganda e qendrës (Gazetat qendrore, kryesorja e të cilave ishte “Bashkimi” shënim) që edhe juve mbi bazën e këtyre pikave ta shpini në terren këtë agjitacion me anë të mjeteve tuaja propagandistike”, thuhet në këtë telegram të nënshkruar nga Nako Spiru<sup>6</sup>.

Në këtë mënyrë “Bashkimi” kthehet në një lider të demonstrimit të vijës politike që duhet të ndiqte i gjithë shtypi shqiptar. Por, me acarimin e luftës së klasave, situatës ndërkombëtare Komisioni i agjit-propit vendos të “disiplinojë” edhe gazetën kryesore atë që shërbente si shembull të gazetave të tjera qofshin këto qendrore apo lokale, gazetën “Bashkimi”.

“Tue fillue prej datës së sotme redaksisë së gazetës tuej herë mbas herë do t’i vij nga Komisioni i agjit-propit pranë Komitetit Qendror të Partisë një letër të cilën duhet t’a punoni në redaksi”, shkruhet në letrën e parë të nënshkruar nga Fadil Paçrami. Letra do të përmbante kryesisht vërejtje mbi gazetën dhe udhëzime e direktiva për zhdukjen e atyre të metave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të gazetës”. Dhe rekomandimi i parë i Komisionit të agjit-propit ishte; “Gazeta Bashkimi duhet të nxjerrin qartë e drejtë politikën e Partisë prandaj kërkohet që gjanat që shkruhen të jenë shkrojtur drejt, qoftë për sa i përket vijës së përgjithshme të Partisë, qoftë për sa i përket vijës së partisë për sektorët e ndryshëm. Për këtë asht e domosdoshme që shokët e redaksisë të studjojnë mirë të gjitha çështjet simbas mësimëve të Leninit e të Stalinit. Shokëve të Redaksisë “Bashkimi” i hiqet vërejtja pse nuk tregojnë asnjë kujdes për me studiuë. Duhet të

5 AQSH. F.14. V. 1946. D. 131. ff 34-35

6 AQSH. F.14 V. 1946. D. 171. ff.54.

kuptohet mirë se pa studimin e mësimëve të Stalinit në lidhje me fshatin etj.. ju nuk mund të kuptoni drejt problemin e fshatit tek neve nuk mund të kuptoni e si rrjedhimisht shkruani drejt për çështjen e grumbullimit të bereqetit.

Dhe një ndër të metat ishte se "Asht mjaft e dobtë puna që bën redeaksia e lajmeve të jashtëme, ajo nuk ka plan e nuk i ndjek gjanat. Me qëllim që të forcohet informacioni i gazetës në lidhje me problemet e jashtëme duhet të fillohet me lanë më shumë vend në faqen e parë për çështje të jashtëme. Njëkohësisht duhet me ba më shumë komente t'ona mos me lanë pa shfrytëzue raste që demaskon vendin imperialist e politikën e tyre".

### *Ligji mbi shtypin, mekanizmi ligjor i censurës*

Në të njëjtën kohë me ngritjen e agjit-propit shteti komunist aprovon edhe ligjet për të kontrolluar veprimtarinë e medias. Ligji i parë në fushën e medias ishte Ligji i posaçëm "Mbi krijimin e masagjerisë së Përgjithshme të Shtypit", i hartuar nga Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar. Ky ligj synonte vënien nën kontroll të shpërndarjes së shtypit. Që në nenin 1 të këtij ligji që mban numrin 112 dhe ditën e miratimit 30 gusht 1945, sanksionohet se: "Kjo mesazheri kishte si "qëllim që të shpërndajë, të përhapë dhe të reklamojë botimet e ndryshme (gazeta, revista, broshura, libra etj) të botuara prej Enteve Shtetërore ose prej Organizatave të Frontit Demokratik, ose prej privatëve si dhe të përkrahë botimin e librit duke blerë vepra nga autorë dhe duke i botuar për llogari të saj.

Paralelisht me institucionalizimin në të gjitha nivelet e Komisionit të agjit-propit, Ministria e Shtypit Propagandës dhe Kulturës Popullore nëpërmjet një urdhërese të nënshkruar nga Sejfulla Maleshova, ministër i kësaj Ministrie, ndalonte "të gjithë privatët, organizatat, entet, bibliotekat, shtëpitë e kulturës, institucionet fetare, etj.. të mbajnë dhe të vënë në qarkullim, në formë tregtie ose jo, çdo lloj publikacioni të huaj, pa autorizimin e drejtorisë së Shtypit dhe Propagandës". Sipas këtij urdhri vetëm Mesagjerja e Përgjithshme e Shtypit mund të lidhi kontrata me shtëpitë e huaja për çdo lloj publikacioni, dhe vetëm ajo është e ngarkuar me shpërndarjen e publikacioneve të huaja. "Ministria e Shtypit Propagandës dhe Kulturës Popullore u la dhjetë ditë kohë atyre që bëjnë këtë aktivitet, pra që shpërndajnë shtypin ose çdo lëndë tjetër propagandistike të paraqiten pranë drejtorisë së Shtypit dhe Propagandës për të rimarrë lejen dhe kërcënoi kundravantësit se "do të pësojnë konsekuenca e ligjit"<sup>8</sup>.

<sup>7</sup> AQSH, F.14, V. 1947, D. 306, f.66-67

<sup>8</sup> "Urdhëresë e Ministrisë së Shtypit Propagandës dhe Kulturës Popullore" *Bashkimi*, 19.02. 1946, nr 352, Fq.4

Dy vjet më pas, në nëntor 1947 Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, shpall ligjin për shtypin, një nga ligjet që është cilësuar shumë i rëndësishëm në median e kohës sepse garanton dhe mbron fjalën e lirë. Por, në fakt me këtë ligj vendoset kontrolli në formë dhe censura në përmbajtjen e tij. Edhe pse fjalja e parë e nenit 1 të këtij ligji siguron se “Shtypi i Republikës Popullore të Shqipërisë është i lirë”, në po këtë nen paralajmërohej se kishte edhe raste të parashikuara në këtë ligj që shtypi do të frenohej.

Sipas nenit 4 të këtij ligji, kushdo që do të nxirrte një gazetë apo revistë duhej së paku 14 ditë para publikimit të numrit të parë t’i paraqesë Prokurorit të Rrethit (organ hetimi) kërkesën e cila duhet të përmbante titullin e medias, identitetet dhe mjeshtërinë e botuesit, dhe të të gjithë stafit të redaksisë, vendin e botimit dhe emrin e shtypshkronjës e karakterin e medias. Nga ana tjetër, ligji i hoqi të drejtën botimit apo edhe të shkrimit një numri shumë të madh gazetarësh. Ligji u ndalonte të botonin ose të punonin në një media, këtyre kategorive; ata që kishin humbur të drejtat civile apo politike, ata që kishin qenë funksionarë ose edhe anëtarë të organizatave të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit ose të ndonjë organizate tjetër fashiste brenda ose jashtë vendit, si dhe ata që kishin bashkëpunuar me fashizmin ose me ndihmësit e tij. Ata që kishin qenë botues ose edhe gazetarë, madje edhe shkrimtarë të librave, gazetave apo botimeve të tjera fashiste dhe profashiste. Dhe atyre, që qysh nga 7 prilli 1939 e deri në çlirimin e Shqipërisë kishin qenë botues, redaktorë, bashkëpunëtorë aktiv dhe shkrimtarë librash apo gazetash me anën e të cilave është mbjellë përçarje në popullin shqiptar dhe nëpërmjet popullit shqiptar dhe popujve të tjerë fqinj ose jo. Si dhe ata që kanë marrë ndihmë nga armiqtë e jashtëm të Shqipërisë. Dhe në fund u ndalohej të shkruanin apo botonin ata që e kishin përdorur shtypin për qëllime imorale<sup>9</sup>.

### *Censura në përmbajtje*

Prokurori i rrethit në fakt nuk kishte vetëm të drejtën e licencimit të një gazete. Të drejtat e tij në raport me median ishin të pakufizuara. Në nenin 13 të këtij ligji thuhej se prokurori i rrethit ka të drejtë në raste të ngutshme me vendim të arsyetuar të ndalojë përkohësisht shpërndarjen dhe shitjen e librave, gazetave dhe botimeve të tjera. Vendimi i prokurorit i njoftohet redaksisë dhe më pas gjykatës. Kjo e fundit detyrohet që brenda 24 orëve të vendosë datën e gjyqit për të shqyrtuar aktin e prokurorit. Por, për këtë datë nuk e kushtëzohet njeri në afat. Por, frika ligjore që të çon rrjedhimisht në një autocensurë shtohet edhe nga një tjetër nen i këtij ligji.

<sup>9</sup> “Dekret ligji mi shtypin”. *Gazeta Zyrtare*, 8 janar 1948. Nr.5, fq.4.

Nëse një media është ndaluar tre herë nga gjykata, atëherë kjo gazetë mund të mbyllet përgjithmonë. Dhe arsyet e ndalimit ishin dhjetë, respektimi rigoroz i të cilave çonte në një censurë totale. Një botim mund të ndalohej nëse propagandon, nxit ose mbjell urrejtje dhe përcarje në mes popullit shqiptar, për shkak kombësie ose feje. Gjithashtu, të njëjtën foto do të kishte edhe nëse media propagandon, nxit ose mbjell urrejtje midis popullit shqiptar dhe popujve të tjerë fqinj ose jo. Në media ndalohej thirrja për kryengritje, sabotim ose nxitje për të ndryshuar rendin konstitucional të vendit me qëllime antidemokratike. Në pikën e pestë sanksionohej edhe natyra e shkrimeve për problemet ndërkombëtare. "Ndalohej shpërndarja dhe shitja e librave, gazetave respektive dhe botimeve të tjera që përmbajnë ofendime ose çpifje kundra vendeve mike me qëllim që të tronditin marrdhëniet e mira dhe paqen ndërkombëtare"<sup>10</sup>. Pra, nëpërmjet këtij neni sigurohet që shkrimet për vendet mike të ishin gjithmonë pozitive. Dhe me nenin pasardhës, garantohet sulmi ndaj vendeve armike. "Ndalohej shpërndarja dhe shitja e librave, gazetave respektive dhe botimeve të tjera që përmbajnë aprovim ose ndihmë të aktivitetit të armiqëve të jashtëm të R.P. të Shqipërisë"<sup>11</sup>. Në këtë mënyrë shteti i kohës futi një herë e mirë në korniza ligjore median e kohës, duke sanksionuar nëpërmjet ligjit censurën.

Të njëjtat korniza censure ishin caktuar për shtypin e huaj. Në fillim thuhej se shtypi i huaj mund të shpërndahej në Shqipëri pa asnjë autorizim. Por, një nen më poshtë sanksionohej se "dispozitat e neneve 11 e 12 të kësaj Dekret-Ligje (ato që kanë të bëjnë me ndalimin e shtypit. Z.B.) zbatohen edhe për shtypin e huaj. Vetëm se vendimi i ndalimit në këtë rast nuk bëhet nga prokurori i rrethit, por nga Sekretari i kryeministrit.

Të gjitha shkeljet e mësipërme konsideroheshin si shkelje penale dhe dënoheshin në masën më të madhe me burg. Ndërsa një pjesë edhe me gjobë edhe me burg.

### *Media sovjetike, burim i vetëm për lajmin ndërkombëtar*

Shqipëria e porsa dalë nga lufta ku shkalla e analfabetizmit ishte në përmasa të mëdha, kishte mungesa sa në burime njerëzore aq edhe në teknike për të nxjerrë një media profesionale. Petro Marko, kryeredaktori i parë i "Bashkimi"-t kujton në këtë mënyrë këtë situatë; "Pa lajme nga agjencia, pa korrespondentë nga krahina, pa korrespondentë specialë, pa një kolegji, pa një redaksi që të bënte një plan javor apo ditor! Kjo vazhdoi gjersa na erdhi shoku Nako Spiro, i cili herë pas here shkruante artikuj me rëndësi. Ai i dha një ton revolucionar Gazetës, duke prurë shokë si Luan

<sup>10</sup> Po aty

<sup>11</sup> Po aty



Omari, Stefenaq Pollo, Androkli Kostallari, Javer Malo, Myzafer Xhaxhiu, Aleks Çaçi, e disa të tjerë<sup>12</sup>.

Pos këtyre argumenteve ose mangësive, mendoj se edhe për shkak të situatës ndërkombëtare, zhvillimeve të vrullshme, vazhdimit të Luftës së II-të Botërore në “Bashkimi”-n e fundvitit 1944 dhe në gjysmën e parë të vitit 1945, mbizotëronte lajmi ndërkombëtar.

“Lajmet i mirrja nga Radio Moska dhe aty për aty i jepja për rradhitje. Kishim vendosur një hartë të madhe të Evropës dhe shihnim qytetet e Evropës Lindore që dita ditës çliroheshin nga Ushtria e Kuqe. Titulli i përhershëm i faqes katër ishte; “Drejt Berlinit”<sup>13</sup>.

Mbizotërimi i lajmeve ndërkombëtare duket qartazi që në faqen e parë të gazetës “Bashkimi”. Në këtë faqe kishte shumë, dhe shpesh lajme nga bota ose lajme për çështje ndërkombëtare. Në ditë të caktuara faqja e parë ishte në masën 90 përqind me lajme ndërkombëtare.

Ndërsa rasti më i rrallë është ai i datës 14 gusht 1945 kur faqja e parë kishte vetëm lajme nga bota. Asnjë lajm nga vendi. Madje edhe editoriali ishte për një problem ndërkombëtar.

Ja lajmet e asaj dite;

“Një mbret i vdekur moralisht”. Dr. Omer Nishani.

Qeveria Jugosllave i përgjigjet pretendimeve të Mbretit Pjetër.

Trupat aleate gati të zbarkojnë në Japoni.

Festa e Sportit në Bashkimin Sovjetik.

Mbi fjalën e Presidentit Truman.

Politikanët grekë të mos rrojnë me ëndrra. Gazeta New York Post me pretendimet greke

Regjenti Damaskinos është përgjegjës për gjendjen e sotme në Greqi.

Gjyqi i Petainit/Prokurori kërkoi dënimin me vdekje.

Reformat e Qeverisë së re britanike.

Nga kongresi i Partisë Socialiste Franceze.

Rubrika “Me dy fjalë” për lajmet ndërkombëtare.

Në faqen e parë shpalohej edhe qëndrimi politik i gazetës nëpërmjet editorialeve, të shkruar fillimisht në pjesën e parë të vitit 1945 nga Lame Kodra dhe më pas kryesisht nga Dr. Omer Nishani dhe Dr. Ymer Dishnica.

Por më vonë, me orientim të Komitetit të agjit-propit në një javë nuk mund të bëheshin më shumë se katër kryeartikuj (Mesa duket me konceptin e kryeartikullit ata quajnë editorialet, dhe jo artikullin kryesor me të cilën është i barasvlershëm sot kryeartikulli. Shënim). “E përsërisim

<sup>12</sup> Petro Marko, “Kujtime të Viteve/Shtypi ynë menjëherë pas çlirimit”, *Tribuna e Gazetarit*. Tiranë, 1972. Nr.3, fq 18-19

<sup>13</sup> Po aty.

gjithnjë atë që kemi thënë kaq herë, se kryeartikujt nuk mund të bëhen mbrenda pak orëve ose mbrenda një dite. Për kryeartikujt duhet me punue ma shumë. Kryeartikujt nuk mund të kenë tonin e thjeshtë të qarkoreve, mos të merremi me çështje të vogla as të mos të binë në përsëritje. Në një javë mos të ketë ma shumë se katër kryeartikuj. Herë pas mbase here duhet të vehen edhe lajme qoftë të jashtëme ose të mbrendshme<sup>14</sup>.

Rrjedhimisht në "vend të editorialeve" kishte edhe lajme, komente të përkthyer nga gazeta sovjetike, "Pravda" gjë që tregon se "Bashkimi", bënte pjesë të opinionit të tij, ose të linjës së tij editoriale edhe qëndrimin e kësaj gazete lidhur me çështjet ndërkombëtare.

Në faqen e dytë dhe të tretë gazeta kishte lajme nga rajonet kryesore të Shqipërisë, që tregonin për aspektet e ndryshme të jetës shqiptare, atë ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Në faqen e dytë ka shpesh herë rubrikën "Nga krahinat e vendit". Ndërsa në faqen e tretë ka reportazhe nga vendi, të cilat i ka shkruar në masën më të madhe Petro Marko. Por pas (zhdukjes) arrestimit të tij në gazetë nuk po shkruhej më me emra, madje as me pseudonime. Shkrimet ishin pa autorë. Në këtë faqe ka edhe përkthime nga letërsia ruse. Por edhe analiza të gjata politike, si ajo për Greqinë, për Spanjën. Po në faqen e tretë ka edhe botim letërsie, siç është rasti i botimit të Letërsisë amerikane (një cikël shkrimesh në fillim të vitit 1946, nga Peral Buck, nobelist), por edhe letërsi ruse, apo të vende të tjera. Po në faqen e tretë kishte përkthime nga shtypi ndërkombëtar, për çështje të mëdha ndërkombëtare, marrë kryesisht nga revista "TEMPS NOUVEAUX" (Kohë e reja) apo "Borba".

Pamundësisë së redaksive shqiptare për të mbushur cilësisht faqet e periodikëve si dhe synimi për të propaganduar gjithçka sovjetike çoi në marrëveshje të institucionalizuar për të marrë "hua" artikuj nga media sovjetike.

Në fund të vitit 1946, Sovinformi, struktura e agjitacionit dhe propagandës në Bashkimin Sovjetik, nëpërmjet Atasheut Shqiptar të Shtypit në Moskë u kërkon gazetave shqiptare që të paraqitnin që në fillim të vitit 1947 kërkesat për numrin dhe llojet e artikujve që dëshironin. "Lutemi të lajmërohen mi këtë gjë gazetat si "Bashkimi", "Luftëtari", "Puna", "Rinija" etj. në mënyrë që të përgatitin dhe t'ja paraqesin sa më shpejt Sovinformit kërkesat e tyre për vitin 1947. Sovinformi nuk din se ç'lloj dhe ç'sasi materiali duhet me u dërgue gazetave shqiptare. Prandaj pritët që gazetat t'a caktojnë vetë llojin dhe sasinë e materialit që u duhet për vitin 1947, siç kanë ba edhe gazetat e vëndeve të ndryshme që marrin material nga Sovinformbyroja". Kështu thuhet në një telegram që ministri

14 AQSH, F. 14, V. 1947, D. 306, Fq.66-67. Letër që Kryetari i Komisionit të agjit-propit Fadil Paçrami i dërgon redaksisë së bashkimit.

fuqiptotë shqiptar në Moskë (ambasadori, shënim) i dërgonte Ministrisë së Jashtme më 14 shkurt 1947<sup>15</sup>.

Pak javë më pas, gazeta “Puna” depoziton e para kërkesat e saja për rreth 150-200 artikuj për gjatë gjithë vitin, që përlllogaritet rreth 2-3 artikuj në çdo numër. “Gjatë vjetit 1947 do të na nevojiten për organin t’onë këto llojë lënde;

- a) tregime, novela dhe skica letrare nga heroizmat sovjetikë në rindërtimin e vendit, vigjilencën, kursimin, moralin e punëtorit sovjetik etj.
- b) Artikuj eksperience mbi punën me gara, organizim të Sindikatave dhe të punës në përgjithësi në B.R.S.S.
- c) Korrespondenca mbi vendimet, ndryshime në organizim dhe ngjarje në Sindikatat Sovjetike dhe në jetën e punëtorëve dhe nëpunësve Sovjetikë.
- d) Tregime mi jetën dhe veprat e udhëheqësit bolshevikë.
- e) Artikuj mi sukseset në Sektorët e ndryshëm të ekonomisë<sup>16</sup>.

Në arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme nuk gjendet përgjigja e gazetës “Bashkimi”, por në faqet e saj gjenden qindra artikuj të përkthyer nga media ruse. Publikimi i artikujve nga Bashkimi Sovjetik i shërbente së pari propagandës dhe agjitacionit për arritjet, jetën e bukur dhe demokracinë në Bashkimin Sovjetik. Këto artikuj ishin edhe një mënyrë e mirë për të mbushur, plotësuar mangësitë për lajme që shkaktoheshin nga faktorët që thamë më sipër, (mungesa gazetarësh, korrespondentësh). Por kjo bëhej edhe për t’i ndjekur më pas këto lloj shkrimesh edhe si modele për të shkruar rreth jetës së re shqiptare, që po ecte në gjurmët e “demokracisë së re Sovjetike”.

Sasia dhe shpeshësia e botimit të lajmeve ndërkombëtare në mediat shqiptare ka qenë aq evidente sa medias, (Komisionit të agjit-propit) i është “tërhequr veshi” nga Byroja Politike. “Me anën e Bashkimit duam të informojmë e të orientojmë drejt popullin dhe synojmë mos me e ba gazetën vetë një bulletin të Tassit e të Tanjugut, por një organ indipendent përsa i përket çështjeve t’ona, çështjeve të Ballkanit dhe për çështje të Evropës”<sup>17</sup>.

Përveç vendit që zinin në faqen e parë dhe të tretë, lajmet nga bota kishin të tyre edhe faqen e katërt. Por, nëse në faqen e parë përzgjidheshin lajmet të rëndësishme, për të cilat ishte tepër e interesuar Shqipëria në faqen e katërt mund të vendoseshin edhe lajme ndërkombëtare, sociale, ekonomike, kulturore dhe sportive.

15 Arkivi i MPJ. Viti 1947. Dosja 13. Fleta 4.

16 Arkivi i MPJ. Viti 1947. Dosja 13. Fleta 6.

17 AQSH. 1946. F.14. D.10. Fl.2. Nga mbledhja e Byrosë Politike. Datë 17.10.1946.

Po në këtë faqe, pra në faqen 4, kishte edhe lajmërimet të ndryshme duke i ndarë në “Lajmërimet me randësi”, “Lajmërimet zyrtare”, apo edhe njoftimet të ndryshme për aktivitete kulturore, apo për filmat që shfaqen në kinematë e Tiranës, atë “Tomorri” dhe atë “Nacional”. Si dhe lajme sportive.

Në gazetë vihet re mungesa thuajse totale e fotografisë, sidomos kjo në faqen e parë. Vendosen fotografi vetëm në raste ngjarjesh të mëdha, siç është rasti i 10 korrikut 1945, kur si asnjëherë tjetër në faqen e parë vendosen dy foto. Njëra e kolonel Enver Hoxhës dhe tjetra e Gjen. Lejtnant Koci Xoxe, që tregon momentin kur Shtabi dhe Qeveria hyn në Tiranë, ditën e çlirimit. Ose rasti i festimit për herë të parë i festës së çlirimit, datës 29 nëntor 1945, kur në faqen e parë vendosen tre fotografi. Në krye fotoja e Skënderbeut. Dhe poshtë tij paralelisht fotoja e Ismail Qemalit dhe Enver Hoxhës.

Ndryshe ndodhte me revistën “Shqiptarja e Re”, e cila gjithmonë në kopertinën e parë dhe të fundit kishte fotografi, zakonisht nga jeta e femrës shqiptare. Por nuk mungonin edhe foto të Enver Hoxhës dhe të Gjeneralizmit Stalin. Madje “Shqiptarja e re”, ka pasur foto edhe në faqet e brendshme. Aq pas vitit 1946, kishte foto në çdo faqe. Lajmet ndërkombëtare nuk kishin më burim “Reuters”-in siç ndodhte në fillim të vitit 1945, por vetëm agjencisë Tanjug dhe TASS. Në lajmet e shkruara nis të mbretërojë komentit. Dhe nuk ka një ndarje të qartë midis faktit dhe komentit. “Sidoqoftë, mësohet se duke hequr dorë nga parulla “pamvarësi për kollonitë”, Amerika është në rrezik të humbasë përfitimet politike me rëndësi”<sup>18</sup>.

Ndërsa në një artikull mbi situatën në Greqi, artikullshkruesi J.M (Mendoj Javer Malo shënim) e nis në këtë mënyrë shkrimin: “Pyeta dje një shok që vinte nga Gjirokastra për gjendjen në Greqi. Ai më tha se ka ca ditë që kthehen atje nga Greqia Minoritarët, të cilët ndodheshin në Janinë. Gjendja andej brenda është mëse kaotike”<sup>19</sup>.

Madje edhe disa nga titujt janë të natyrës së komentit ose parullave mobilizuese. Për shembull: “Të gjithë në fushatën elektorale”. “T’u mbjellim tokën tonë”. “Populli kudo kërkon republikën demokratike”. “Ne jemi të Titos, Tito asht i joni”. “Kryeartikujt, artikujt, reportazhet, korrespondencat, etj, ruanin frymën luftarake dhe shkruheshin nga gazetarët e rinj me patos revolucionar dhe me nivel të mirë publicistik”, kujton një nga kryeredaktorët e “Bash kimit”, Stefanaq Pollo, rreth 40 vjet më pas<sup>20</sup>.

18 “Nga Konferenca e San Franciskos”. *Bashkimi*. Tiranë. 22 maj 1945. Nr. 129. fq. 4.

19 “Fashistët Grekë si gjithnjë në gjurmët e Goebelsit e të Himmlerit”. *Bashkimi*. Tiranë. 5 korrik 1945. Nr. 169. fq. 1-4

20 Dr. Stefanaq Pollo. “Fillimet e para të një gazete militante”. *Tribuna e Gazetarit*. 1984. Nr.4. fq.5.6.

Ka tek tuk raste kur faktet ndahen nga komentet. Një rast i tillë është ai i datës 16 tetor 1945, kur në faqen e parë të gazetës “Bashkimi” jepet lajmi me titull “Vehbi Frashëri arrestohet si kontrabandist”. Fillimisht jepet fakti i cili jepet edhe me germa Bold, për ta dalluar nga pjesa tjetër. Lajmi është: “Informohemi nga Roma se djali i Mehdi Frashërit, Vehbi Frashëri, ish-ministër i Jashtëm në kohën e babit të tij, është kapur dhe arrestuar nga policia e Romës si kontrabandist floriri në bashkëpunim me një gjerman. Iu gjetën përsipër 4 milion lireta dhe një sasi e madhe kartëmonedhash të huaja.

Më poshtë kryeradhë nis komenti: E kemi thënë edhe herë tjetër se si tradhëtorët dhe kriminelët e luftës jetojnë në Itali me dallavere, me kontrabanda, sipas zanatit të tyre. Sa qenë këtu vodhën dhe ropën dhe pastaj ikën bashkë me patronët e tyre”....

Por, me kalimin e kohës në gazetë mbretëron vetëm komenti, madje edhe lajmet jepen duke i komentuar. Në “Bashkimi” kishte edhe tek – tuk edhe lajme të kronikës së zezë, që raportoheshin pasi zbuloheshin krimet me okelion “Suksese të policisë s’onë”. Por edhe këtu gazeta kalon kufijtë e saj dhe apelon për dënimin kapital të autorëve. Në fund të një artikulli për zbulimin e një vrasje vërtetë makabre, gazeta (në numrin shumë) shkruan; “Ne presim që këto bishë të egra, me fytyrë njeriu, që janë një turp për vendin t’onë të paguajnë me kokë krimin e shëmtuar që bënë”<sup>21</sup>.

Gazetës nuk i mungojnë reportazhi, por edhe fejtoni. Si dhe rubrika e historisë ku evidentoheshin dëshmorë të luftës. Pjesa e letërsisë dhe artit. Por, të gjitha këto janë në funksion të programit politik të shtetit komunist. Reportazhi bëhej për të rritur frymën revolucionare për aksionet e rinisë, për fushatën kundër analfabetizmit etj. Në gazetë trajtohen edhe problemet sociale për mjekësinë, por edhe “Mi përkthimet” (problemët letrare) etj, ose rubrika mbi historinë.

Është për t’u theksuar se shtypin e kohës e karakterizonte edhe një fenomen tjetër. Pothuaj të gjitha organet, “Bota e re”, “Shqiptarja e re”, “Djersa”, kishin një rubrikë të njëjtë, të titulluar “Posta e Redaksisë”. Në këtë rubrikë, lexuesit merrnin përgjigje për problemet që ata kishin, qoftë për problemet lidhur me shkrimet e gazetës, qoftë për probleme të ndryshme për të cilat gazeta interesohet dhe kthente një përgjigje. Një prirje kjo që demonstroi karakterin demokratik dhe dëshirën për interaktivitet të drejtuesve të medias me lexuesin, por që pas vitit 1946, e në fillim të vitit 1947 zhduket si praktikë, çka tregon ndryshimin e kursit të shtypit, futjen e tij në kornizat e politikës së kohës, ose mungesën e demokracisë për pushtetin e katërt.

21 “Arrestohet një kontrabandistë”, *Bashkimi*, Tiranë, 23 shkurt.1946. Nr. 355, fq.3.

Përfundimisht, mund të thuhet se shtypi i kohës sipas të dhënave, devijonte shumë nga karakteri informativ, duke u shmangur kështu nga misioni themelor i medias. Si funksion kryesor i tij konsiderohej, ana propagandistike e agjitative. Një dukuri e tillë vërehet jo vetëm në shtypin shqiptar, por edhe në shtypin e vendeve të tjera komuniste. “Është detyre e çdo gazetari të ndershëm që të radhitet në radhën e luftëtarëve aktive për paqen dhe demokracinë, të japin të gjithë fuqinë e talentit të tyre, flakën e zemrës së tyre, mprehtësinë e pendës së tyre në luftë kundër nxitësve të luftës, për lirinë dhe jetën e lumtur të njerëzimit” Kështu, thuhet në manifestin e pjesëmarrësve të Konsultës së gazetarëve të vendeve Sllave që u mbledh në Zagreb në janarin e 1948-ës. Kjo konferencë u mbaj posaçërisht për të forcuar shtypin e vendeve përparimtare të botës. Manifest që e “përqafoi”, bëri pjesë të filozofisë së tij edhe shtypi shqiptar<sup>22</sup>.

Pra, kriteret për një gazetari profesionale nuk ishin vërtetësia, balanca dhe ekuilibri, por “lufta nëpërmjet pendës së mprehur” për të mbajtur në këmbë demokracinë popullore. Përmbajtja e shtypit të këtyre viteve, por përgjithësisht e shtypit të 40 viteve të PKSH-së, ka qenë e partishme, militante dhe apologjiste, në shërbim të popullarizimit, zbrërthimit dhe zbatimit të programit të asaj partie.

“..agjitacioni dhe propaganda sot duhet të jenë të lidhur me akcionin. Por kjo duhet të kuptohet mirë, se roli i agjitacionit dhe propagandës nuk konsiston vetëm në mobilizimin e popullit aty për aty, vetëm në arritjen e disa rezultateve imediate. Agjitacioni dhe propaganda ka për detyrë të synojë më larg, të ngrërë nivelin politik të masave, t'i bëjë ato më të afta për të kuptuar politikën e shtetit dhe të partisë s'onë”. Kjo është deviza e organit të posaçëm “Agitatori” në editorialin e saj të numrit të parë<sup>23</sup>.

Por, edhe pse agjitacioni dhe propaganda zhvilloheshin në “konditat e ndërtimit paqësor të vendit, kjo nuk do të thotë se ajo (propaganda, shënim) është e zhveshur nga karakteri militant, revolucionar”<sup>24</sup>.

Përkundrazi, agjitacioni dhe propaganda e partisë ka gjithmonë rolin që të zhvillojë një luftë, jo vetëm kundra pengesave e vështirësive të ndryshme, por sidomos kundra armiqve të popullit, elementëve reaksionarë, agjentëve të imperializmit dhe sabotatorëve të rindërtimit. Kjo luftë është e pandarë nga përpjekjet për ndërtimin e Shqipërisë së Re. Në këtë pikë agjitacioni dhe propagandë e jonë duhet të ruajë një trashëgim të vlefshëm prej luftës NÇ.<sup>25</sup>

22 “Manifesti i pjesëmarrësve të konsultës së gazetarëve të vendeve sllave në Zagreb”. *Shqipëri-Jugosllavi*, Tiranë, 1948. Nr.3. fq. 28-29.

23 “Agjitacioni dhe propaganda në konditat e rindërtimit dhe ndërtimit të vendit t'onë” *Agitatori*. Tiranë, Qershor 1947. Nr.1. fq.5-6.

24 Po aty.

25 Po aty.

Sërish njëri nga kryeredaktorët e saj kujton; “Gazeta “Bashkimi” duke zbatuar me përpikëri porositë e shokut Enver mbeti një gazetë militante, një zëdhënëse besnike e vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë. Atëherë nuk kishte korrespondentë vullnetare në qarqet e punën e tyre duhet të bënin të dërguar të qendrës<sup>26</sup>.

Në përfundim të këtij punimi mund të konkludojmë se media është cilësuar si një armë në duart e pushtetit të kohës dhe është trajtuar si e tillë, njëlloj si të gjitha pushtetet e tjera që ishin në funksion të partisë-shtet.

---

26 Dr. Stefanaq Pollo, “Fillimet e para të një gazete militante”. *Tribuna e Gazetarit*. 1984 . Nr. 4. fq.5-6.

**Mz. Zylyftar BREGU**

## **SUMMARY**

### **THE SEKTOR AGITPROP AND INSTITUTIONALIZATION OF CENSURE IN PRINT MEDIA AFTER 1944**

By the end of the war, with Communist Party rendering more power its press intensified the revolutionary character. The Communist press began assaulting with the strong tones in all directions. Later revolutionary government bodies established following the Congress of Përmet, in particular began to target closing one by one the all press organizations that countered the so-called spirit of war and National-Liberation Councils.

The Communist leader Enver Hoxha referring to the governmental report concerning the press in Albania in September 1945, provided following figures: "In the capital and the provinces circulate 13 newspapers, one of which a daily edition with 12000 copies circulation, 50 monthly magazines publish so far, with one satirical, bi-weekly edition. Except publications of the Ministry of Education there been about 40 different books in circulation, three radio-stations, one in Shkoder, Korca and the other in Gjirokastra, in addition to Radio Tirana, and radio Lartika has been rebuilt.

The situation was different with the magazine "Sheqeriza e Re" which always on the front page cover and the last page enclosed usually character of Albanian woman. Nevertheless, it also incorporated pictures of Enver Hoxha and Stalin. Furthermore "Sheqeriza e Re" included pictures in the internal pages, and even after 1946, there were pictures on each page. International News excluded "Reuters" as source by the early 1946, to be replaced by Tanjug and TASS agencies only. In the printed press begins prevailing commentaries with no clear distinction between the fact and comment.